

Shëndeti i bimëve për jetën – përforcimi i veprimeve të thjeshta që mbrojnë bimët

Shëndeti i bimëve për jetën – përforcimi i veprimeve të thjeshta që mbrojnë bimët

TFushata "Shëndeti i bimëve për jetën" kthehet për vitin e saj të katërt dhe të fundit, në vazhden e një përpjekjeje të përbashkët nga Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore (EFSA), Komisioni Evropian dhe 33 shtete, për ta vendosur shëndetin e bimëve në fokus të zgjedhjeve tona të përditshme.

Që në nisje, fushata është përqendruar në lidhjen e ngushtë të shëndetit të bimëve me jetën e përditshme - nga ajo që hamë, deri te mënyra se si udhëtojmë, merremi me kopshtarinë dhe blejmë. Në këtë vit të fundit, fushata "Shëndeti i bimëve për jetën" mbështetet në progresin e arritur, duke i inkurajuar njerëzit në të gjithë Evropën të qëndrojnë të informuar, të përhapin mesazhin dhe të ndër marrin veprime të thjeshta që ndihmojnë në mbrojtjen e bimëve, mjedisit dhe ekonomisë.

"Fushata "Shëndeti i bimëve për jetën" është zhvilluar mbi një parim kyç: ndërgjegjësimi fuqizon veprimin. Në këtë vit të fundit, fushata përforon mënyrën se si mbrojtja e shëndetit të bimëve nënkupton mbrojtjen e ushqimit, mjedisit dhe të ardhmes sonë. Përmes angazhimit të qytetarëve në mbarë Evropën, fushata ka hedhur themele të forta që do të vazhdojnë të mbështesin përpjekjet për të mbrojtur bimët përtej vetë fushatës," u shpreh Sylvain Giraud, Kreu i Sektorit të Shëndetit të Bimëve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Komisionit Evropian për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore.

"Shkenca na ndihmon të kuptojmë rreziqet ndaj shëndetit të bimëve, por kjo nuk mjafton: ne kemi nevojë që evropianët ta lidhin këtë njohuri me jetën e tyre të përditshme. Fushata "Shëndeti i bimëve për jetën" e bën konceptin e shëndetit të bimëve të thjeshtë për t'u kuptuar dhe të vlefshëm. Duke udhëtuar dhe duke bërë pazar me përgjegjshmëri, si dhe duke edukuar brezin e ardhshëm, të gjithë ne mund të jemi pjesë e zgjidhjes," shpjegoi Tobin Robinson, Kreu i Sektorit të Mjedisit, Bimëve dhe Ekotoksikologjisë në EFSA.

"Organizimi i nisjes së fushatës gjatë Presidencës së Qipros, së bashku me zyrtarët e lartë për shëndetin e bimëve nga e gjithë Evropa, vë në pah se si shëndeti i bimëve është një përgjegjësi e përbashkët evropiane. Veprimet e thjeshta nga qytetarët, të mbështetura nga një bashkëpunim i ngushtë midis vendeve, ndihmojnë në mbrojtjen e bimëve dhe të ardhmes sonë," u shpreh Anthemis Melifronidou, Zyrtare e Lartë për Shëndetin e Bimëve në Qipro.

Duke demonstruar se shëndeti i bimëve na prek të gjithëve, fushata "Shëndeti i bimëve për jetën" synon të lërë një trashëgimi afatgjatë ndërgjegjësimi dhe përgjegjësie të përbashkët.

Përhapni mesazhin dhe bëhuni pjesë!

Veprimet e çdo qytetari evropian janë thelbësore për ruajtjen e shëndetit të bimëve. Vizitoni [faqen e internetit](#) të fushatës **#PlantHealth4Life** dhe zbuloni se si fushata nxit publikun që të mbrojë shëndetin e bimëve. Burimet përfshijnë materiale për shtyp, postime në mediat sociale dhe video.

Fushata është e hapur për çdokënd, me një fokus të veçantë të:

- **Udhëtarët kureshtarë**, të cilëve u pëlqen të eksplorojnë botën dhe natyrën.
- **Kopshtarët**, të cilët kultivojnë dhe kujdesen për perimet, lulet dhe pemët e shtëpisë suaj.
- **Prindërit**, të cilët janë të shqetësuar për ushqimin që konsumojnë fëmijët e tyre dhe janë të përkushtuar ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit për brezat e ardhshëm.



Rreth fushatës

#PlantHealth4Life është një fushatë disavjeçare, e zhvilluar me kërkesë të Komisionit Evropian. Ajo bazohet në një [analizë](#) të thelluar të perceptimeve dhe sjelljeve të qytetarëve lidhur me shëndetin e bimëve në mbarë BE-në.

Fushata vijon zgjerimin e objektit dhe shtrirjes së saj, duke mbuluar **33 vende**:

- **Vendet e BE-së:** Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja dhe Suedia
- **Vendet në proces paraanëtarësimi:** Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova*, Mali i Zi dhe Turqia, si dhe
- Zvicra.

**Ky emërtim nuk cenon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë të Kosovës.*

Si ndikon shëndeti i bimëve në jetët tona?

Bimët përbëjnë 80% të ushqimit që konsumojmë, shërbejnë si ushqim për kafshët me të cilat ne ushqehemi, si dhe pastrojnë ajrin që thithim. Por jo vetëm kaq: bimët e shëndetshme nënkuptojnë edhe një rendiment të mirë bujqësor, gjë që ndikon te disponueshmëria e ushqimit dhe te çmimet e ushqimeve për konsumatorët. Shihni më shumë informacion te [roli i bimëve](#).

Ndryshimet klimatike dhe veprimtaritë njerëzore, si tregtia dhe udhëtimet, ushtrojnë presion të konsiderueshëm te bimët. Përhapja e parazitëve dhe sëmundjeve të bimëve mund të ketë pasoja shkatërruese ekonomike dhe mjedisore. Për shembull, nematoda e drurit të pishës është një krimb mikroskopik që mund të dëmtojë me shpejtësi pishat dhe të shkatërrojë pyjet. Nuk u zbulua në BE deri në vitin 1999. I pikasur për herë të parë në Portugali, tashmë është i pranishëm edhe në disa pjesë të Spanjës dhe së fundmi është zbuluar në Francë. Për të ndaluar përhapjen e tij, rregullat e BE-së kërkojnë që të gjitha pemët në rrezik (kryesisht pishat) brenda një rrezeje prej 500 metrash nga infektimi të priten dhe shkatërrohen, duke shkaktuar ndikime të konsiderueshme ekonomike dhe mjedisore, veçanërisht në rajonet me pyje të mëdha pishash.